

V E N D I M
Nr.572, datë 2.9.1996

PËR ADMINISTRIMIN E INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE

Me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Ambientit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Objektet spitalore, qendrat shëndetësore, administratat shëndetësore dhe territoret që ato zotërojnë, në të gjitha zonat urbane dhe rurale të vendit, janë pronë shtetërore dhe administrohen nga drejtoritë e shëndetit publik në rrethe.

2. Ndryshimi i destinacionit në ambientet dhe territoret e objekteve të përfshira në pikën 1 të këtij vendimi bëhet nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Ambientit, me propozim të drejtorive të shëndetit publik në rrethe.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi